



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Company 21” Sh.p.k.
Numri i biznesit - 70124965
Drejtoreshë – Afërdita KELMENDI
OSHMA 21 JUNIOR
Pallati i Mediave/Aneksi 2
Prishtinë

Ref:1812/1307/LIC/ni

VENDIM

për ripërtitjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes 21 Junior, me seli në Prishtinë

FAKTET

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. 21 Junior është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 4 dhjetor 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA 21 Junior.
3. Me datën 4 dhjetor 2018, skadon afati i licencës së 21 Junior, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 29 qershor 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, i ka njoftuar të gjithë të licencuarit si Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, të cilëve afati i licencës ju skadon në vitin 2018, lidhur me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.
5. Më 2 tetor 2018, 21 Junior ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

ARSYETIMI

- Komisioni konstaton se, OSHMA 21 Junior, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedurat e përcaktuara administrative nga KPM.
- Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtëritet licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

VENDIM

- Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me 21 dhjetor 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së 21 JUNIOR, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
- Licenca e KPM-së për OSHMA 21 Junior do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 4 dhjetor 2018.
- Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA 21 Junior, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
- Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21.12.2018
datë